

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-287/13

**Prishtinë,
16 korrik 2014**

Në çështjen juridike të:

S. J.,

Mali i Zi

Paraqitësia e ankesës

kundër

Pala përgjegjëse në kërkesë/ ankesë

E panjohur

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Dag Brathole, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/188/2013 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA28749, KPA 28750 dhe 28751) i datës 13 shkurt 2013, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 16 korrik 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Hedhen si të palejueshme ankesat e paraqitura nga S. J. kundër vendimit të KPCC /D/A /188/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA28749, KPA 28750 dhe 28751), i datës 13 shkurt 2013.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC /D/A /188/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA28749, KPA 28750 dhe 28751), i datës 13 shkurt 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 18 maj 2007 Ž. J. ka depozituar tri kërkesa të regjistruara në AKP (KPA 28749, KPA 28750 dhe KPA 28751) në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës, duke kërkuar të drejtën e ri posedimit. Ajo pretendon se vjehri i saj i ndjerë N. J. është i regjistruar si pronar i pronave paluajtshme të kërkuara.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 21 korrik 2003, nga Komesariati për personat e çvendosur të Republikës së Malit të Zi.
 - Kopjen e Planit të lëshuar nga organi kompetent i Komunës së Podujevës të lëshuar më datë 11.2.1964
 - Ekstraktin e librave amzë së të vdekurve të lëshuar nga organi kompetent i Podgoricës, Republika e Malit të Zi, nr. 09-UPI-204/10/9594 ,në emër të Ž J.. Me këtë ekstrakt konstatohet se Ž. J. ka vdekur me 14 mars 2009 në Podgoricë, Republika e Malit të Zi.
 - Letërnjoftimi i Ž. J. të lëshuar nga organi kompetent i Kurshumlisë nr. 97424 i datës 24. Gusht 1996.
3. Sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronave sipas detyrës zyrtare ka siguruar fletën poseduese nr. 1 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Podujevës me datë 28.2.2008 me të cilën konstatohet se ngastra kadastrale nr. 2 në vendin e quajtur “Lugina-livadhi i epërm” në sipërfaqe prej 0.83.65 ha është regjistruar në emër të M. P. nga fshati Ballovc. Po kështu i njëjti Sekretariat ka siguruar edhe certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme të Zyrës Kadastrale Podujevë, UL-71712004-00001 i datës 14 korrik 2011, me të cilën konstatohet se M. P. është pronar i pronës së paluajtshme të theksuar.

4. Sekretaria Ekzekutive e AKP sipas detyrës zyrtare ka siguruar edhe fletën poseduese të Drejtorisë për Kadastër gjeodezi dhe Pronësi i datës 29.janar 2002, me të cilën konstatohet se ngastra kadastrale nr. 3 e cila gjendet në vendin e quajtur “Lugina-livadhi” në sipërfaqe prej 01.64.75 ha, është regjistruar në emër të Rr. R.. Sikundër për ngastrën kadastrale 3 ashtu edhe për ngastrën kadastrale nr. 2 titullarët e së drejtës së pronësisë janë regjistruar që nga viti 1987.
5. Sipas kopjes së planit të Zonës kadastrale “Ballovcë” i datës 12.9.1964 janë ngastrat kadastrale siç pason:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-287/13 (KPA28749)	Ngastra Nr.3/1, në vendin e quajtur “Livadhet e Milaqiqit” në sipërfaqe prej 01.50.00 ha, me kulturë arë e klasit të IV
GSK-KPA-A-288/13 (KPA28750)	Ngastra nr.3/1 në vendin e quajtur “Milaqiqeve livade” në sipërfaqe prej 0.50.00 ha, me kulturë livadh e klasit të III
GSK-KPA-A-289/13 (KPA28751)	Ngastra nr.2/1 në vendin e quajtur “Milaqiqeve livade” në sipërfaqe prej 04.56,00 ha, me kulturë arë e klasit të IV

6. Ekipi verifikues i Agjencisë Kosovare të Pronave sipas raportit të notifikimit dhe konfirmimit ka bërë notifikimin e ngastrave kadastrale që janë objekt i kërkesës edhe atë si më poshtë:
- Sipas kërkesës së KPA 28749 që i referohet ngastrës kadastrale nr.3/1, është bërë notifikimi me 24 shtator 2010.
 - Sipas kërkesës 28750 që i referohet ngastrës nr. 3/1 është bërë notifikimi me datë 1.shkurt 2008 dhe ri notifikimi në me publikimi me datë 24 shtator 2010 me ç rast është konstatuar se prona e kërkuar nuk është e zaptuar.
 - Sipas kërkesës së 28751 që i referohet ngastrës kadastrale nr. 2/1 është bërë notifikimi me datë 2 janar 2008 dhe ri notifikimi me publikim i dt. 24 shtator 2010 dhe prona e kërkuar nuk është e zaptuar.
7. Komisioni i verifikimit i AKP-së sipas raportit të verifikimit të datës 28.2.2008 ka konstatuar që sipas fletave poseduese të theksuara pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të M. P. dhe Rr. R.
8. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KKPK/D/A/288/2013 datë 13. Shkurt 2013, ka vendosur që kërkesat e Ž. J. të hedhen poshtë. Kjo pikërisht me arsyetim se paraqitësja e kërkesave nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se vjehri i saj në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore e gëzojnë të drejtën për pronat e kërkuara. KKPK-ja i

ka bazuar vendimet e saja në këto arsye: Sekretariati Ekzekutiv ka siguruar ex-offitio dëshmi se pronat e tilla janë të regjistruara në emër të personave të tjerë. Paraqitësja e kërkesës përpos kësaj nuk ka qenë anëtar i bashkësisë familjare sipas nenit 1 dhe 5 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, në mënyrë që të ketë mundësi për të depozituar kërkesë në emër të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore. Përveç kësaj ,paraqitësja e kërkesave nuk ka dorëzuar autorizim të vlefshëm juridik për të qenë i autorizuar që të ndërmerri veprime juridike të vlefshme në emër të vjehrrit të saj në cilësinë e titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore.

Pretendimet ankimore:

9. Ankuesja S. J. në ankesat e paraqitura pretendon se vendimi ankimor nuk përfshinë arsyetime të drejtave të ligjshme. Kjo për arsye se ,pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të vjehrrës së saj Ž. J., ndaj edhe ajo dhe fëmijët e saj kanë të drejtë në pjesën e atyre pronave të paluajtshme. Me ankesën e paraqitur ajo ka deponuar edhe certifikatën e librave amzë së të vdekurve për Ž. J. si dhe fotokopjen e letërnjoftimit të saj.
10. Sonja Jovanović në cilësinë e ankueses vendimin ankimor e ka pranuar më 16 gusht 2013, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 11 shtator 2013.

Arsyetimi ligjor

Bashkimi i ankesave:

11. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkriara, kur për bashkimin apo shkriren e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkriren e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
12. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën e Kontestimeve të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën e Kontestimeve, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

13. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 3 (tri) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.
14. Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-287/2013 deri 289/2013, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-287/2013

Pranueshmëria e ankesave:

15. Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vlerësimit të vendimit ankimor dhe ankesave të paraqitura sipas nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesat janë të palejueshme.

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se kërkesat i ka paraqitur Ž. J. në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht të vjehrrit të saj, tashmë të ndjerë.
17. Paraqitësja e kërkesës dhe Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk kanë siguruar ex officio -sipas detyrës zyrtare dëshminë që sikundër ajo apo vjehri i saj N. J. është titullar i së drejtës së pretenduar të pronave që janë objekt i kërkesave. Pronat e kërkuara sipas fletës poseduese nr. 1 të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi i datës 28 shkurt 2008, ashtu edhe fletës poseduese nr. 2 të Drejtorisë për Kadastre, Gjeodezi dhe Pronësi i datës 29 janar 2002 në cilësinë e pronarëve janë regjistruar M. P. përkatësisht Rr. R.
18. Me datë 15 mars 2010 dhe 1 prill 2010 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka kërkuar nga paraqitësja e ankesave S. J., që të paraqesë autorizim juridikisht të vlefshëm për ankesat e deponuara në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore KPCC/DA/188/2013 i datës 13.2.2013 , por ajo ka dërguar vetëm ekstraktin nga libri amzë i të vdekurve i datës 20.8.2013 dhe letërnjoftimin me datë 26.12.2012.
19. Nga një gjendje e tillë e konstatimeve faktike rezulton se paraqitësja e ankesave nuk është anëtare i bashkësisë familjare i titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara sipas nenit

- 1 dhe 5 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79, e as që ka dorëzuar autorizim juridikisht të vlefshëm për të pasur të drejtë për ankesat e paraqitura.
20. Prandaj rrjedhimisht mbi të mësipërmen, Gjykata Supreme e Kosovës i hodhi ankesat e ankueses si të palejueshme sipas nenit 186 par. 3 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase, paraqitësja e ankesave nuk ka qenë e autorizuar për paraqitjen e tyre, përkatësisht nuk ka paraqitur dhe nuk ka poseduar autorizim juridikisht të vlefshëm për deponimin e tyre. Me dispozitën e cituar juridike parashikohet se ankesa është e palejueshme nëse ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, siç është rasti konkret.
21. Pra, duke qenë se, titullari i së drejtës pronësore të pretenduar dhe paraqitësja e kërkesave kanë vdekur dhe se paraqitësja e ankesave nuk është anëtar i bashkësisë familjare të tyre sipas nenit 1 dhe 5 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 e as që ka deponuar autorizim juridikisht të vlefshëm për paraqitjen e këtyre ankesave, ndaj edhe këto ankesa janë hedhur si të palejueshme sipas nenit 196 të LPK-së.
22. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 ,duke hedhur ankesat e deponuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë ligjore:

23. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it